

Henry H. Perritt, profesor i drejtësisë në Çikago, thur vargje për UÇK-në

Amerikani që i këndon UÇK-së

“Fire for the Colors, a song for the KLA”, apo “Zjarr për flamurin, një këngë për UÇK-në”, është një baladë, inspirimin për të cilën Perritt e ka gjetur tek rrëfimet e shumta të ushtarëve dhe komandantëve të UÇK-së. Këtë këngë, Perritt mendon ta realizojë edhe në një version shqip

KOHA
Ditore

VJOSA LOSHAJ

PRISHTINË, 1 QERSHOR - Këngëtarët Ilir Shaqiri, Shkurte Fejza apo Arif Vladi, nuk janë të vetmit që i kanë kënduar UÇK-së. Muzikës kosovare tani po i shtohet edhe një konkurrent që ka thurur vargje dhe ka kompozuar tinguj muzikorë për ushtarët dhe komandantët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, kësaj radhe autori është amerikan, quhet Henry H. Perritt dhe është profesor i drejtësisë në “Chicago-Kent College of Law”.

Perritt ka qenë në Kosovë shumë herë, prej periudhës së vitit 1998. Që prej kohës së pasluftës, ai e ka vizituar Kosovën disa herë, në projektin “Operation Kosovo” për të ndihmuar në çështjet e zhvillimit politik dhe ekonomik në Kosovë. Por tani, për të njëzetën herë që e viziton Kosovën, ai e ka sjellë me vete një CD me një këngë kushtuar UÇK-së, tekstin dhe muzikën e së cilës e ka bërë vetë. Me qenë se nuk është muzikant profesionist, ai ka bashkëpunuar me artistë amerikanë të muzikës, Tim Sanduskyn si vokalist dhe përcjellës në kitarë, Jamie Gallagherin në bateri dhe Matt Topic në trompetë.

“Fire for the Colors, a song for the KLA”, apo “Zjarr për Flamurin, një këngë për UÇK-në”, është një baladë, inspirimin për të cilën Perritt e ka gjetur tek rrëfimet e shumta të ushtarëve dhe komandantëve të UÇK-së. Këtë këngë, Perritt mendon ta realizojë edhe në një version në shqip. Ai tashmë ka biseduar me këngëtarin Ilir Shaqiri për ta incizuar këtë version të këngës, mirëpo ata janë duke u ballafaquar me një problem. “Njëri nga problemet është se kur kemi filluar ta përkthejmë këngën, na doli se në shqip ka pesëdhjetë për qind më shumë rrokjezim se sa në anglisht dhe kjo do të jetë një sfidë për ne që ta bëjmë këngën shqip të në njëjtën muzikë si në anglisht, por do përpiqemi ta realizojmë”, ka thënë Perritt, duke shtuar se në qoftë se arrihet zgjidhja, versioni shqip do të realizohet për gjashtë javë apo dy muaj.

Po të përkthehet në shqip refreni i kësaj kënge, do të ishte: “Ata na dërguan tek varret tona nën yjet e zjarrita. Ata i duan të gjithë komandantët tanë prapa grilave. Por ne do ta mbrojmë flamurin magjik, në formën e zjarrit tonë të vetëm. Unë do t’ju përgjigjem”.



Perritt shkruan edhe libër për UÇK-në

Gjatë intervistimit të një të riu për një çështje të caktuar, Perritt e ka kuptuar se ai kishte qenë ushtar i UÇK-së. Menjëherë të nesërmen ai është takuar me Ramush Haradinajn dhe ka biseduar me të për ta botuar një libër për UÇK-në. “Jam takuar me Ramush Haradinajn dhe e kam pyetur se çfarë mendon për një libër për UÇK-në dhe ai më ka thënë se është një ide e shkëlqyer, por me një kusht. Duhet ta shkruash. Dhe unë kam thënë se do ta shkruaj”, rrëfen Perritt për librin “The Kosovo Liberation Army: Inside Story of an Insurgency,” (Ushtria Çlirimtare e Kosovës: Rrëfim i brendshëm i një kryengritjeje), i cili do të dalë nga shtypi kah mesi i vitit 2007 në gjuhën angleze. Këtë libër Perritt e ka shkruar nga rrëfimet e më shumë se njëqind ushtarëve e komandantëve të UÇK-së, nga biseda e tij me ish-kryesuesin e Shërbimeve Sekrete të Shqipërisë, Fatos Klosi, si dhe me gjeneralë të ushtrisë amerikane. Përveç synimit për ta bërë versionin shqip të këngës, Perritt e ka ndërmend që deri në vitin e ardhshëm edhe librin ta botojë në gjuhë shqipe. “Libri tani është i përfunduar dhe është në botim e sipër në Shtypshkronjën e Universitetit të Illinoisit, në anglisht. Jam duke biseduar me njerëz këtu që deri në vitin e ardhshëm të kem mundësi ta botoj atë libër edhe në versionin në shqip”, ka thënë Perritt.